




|               |      |          |               |
|---------------|------|----------|---------------|
| Dep.          |      | Nr Prot. |               |
| Dep.          | DPKI | Si. Pro: | 03-02/3340/16 |
| Dep.          |      | Prot No  |               |
| Nr. I faq.    |      | Data     | 28-09-2016    |
| Broj stranica | 02   | Datum    |               |
| Nr. pages     |      | Date     |               |
| PRISHTINE     |      |          |               |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.09.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2970-16, për Zyrtares e lartë, znj. Adelina Valla – Udhëheqëse e financave në Radio Televizionin e Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2970-16, për Zyrtares e lartë, znj. Adelina Valla – Udhëheqëse e financave në Radio Televizionin e Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Valla është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Valla është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Ndërkohë, ajo, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/3179/16) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, znj. Valla tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person e autorizuar në biznesin privat, duke emëruar në këtë pozitë një person të besuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /